

# Deklaratë e të drejtave të personave të ndaluar për vepra të lidhura me terrorizmin

Kjo broshurë ju jep informacione të rëndësishme rreth të drejtave tuaja, sipas legjislacionit skocez dhe Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, gjatë kohës që mbaheni në paraburgim në një komisariat policie. Ky akt ju njeh me drejtat tuaja kryesore gjatë ndalimit. Nuk përbën këshillim ligjor dhe nuk përmban të gjitha të drejtat tuaja. Ju duhet të kërkonti këshillim ligjor në mënyrë të pavarur.

Ju lutemi ta lexoni këtë informacion sa më parë të jetë e mundur. Do t'ju ndihmojë të merrni vendime ndërkohë që jeni në komisariatit e policisë. Mund t'u kërkonti organeve policore t'ju japin shpjegime për gjëra të paqarta në këtë fletëpalosje, t'ju japin kopje më të thjeshtuar ose përkthimin e këtij dokumenti.

## **Mbani mend të drejtat tuaja:**

- 1. Ju keni të drejtën të informoheni se pse policia po ju mban në paraburgim.**
- 2. Ju keni të drejtën t'ju thuhet shkeljet që policia mendon se keni kryer.**
- 3. Ju keni të drejtën për të njoftuar një avokat që jeni në komisariatit e policisë. Ky shërbim është falas.**
- 4. Ju keni të drejtën që të njoftoni dikë se jeni në komisariatit e policisë. Për shembull, ky person tjetër mund të jetë një pjesëtar i familjes, i afërm ose mik.**
- 5. Ju keni të drejtën të qëndroni të heshtur. Nuk jeni të detyruar që t'i përgjigjeni asnjë pyetjeje që ju bën policia. POR, jeni të detyruar të jepni emrin, adresën, datën e lindjes, vendin e lindjes dhe kombësinë.**
- 6. Ju keni të drejtën të flisni privatisht me një avokat përpara se policia t'ju marrë në pyetje. Gjithashtu, mund të flisni me një avokat në çdo kohë gjatë marrjes në pyetje.**
- 7. Nëse jeni nën 16 vjeç ose nën 18 vjeç dhe i nënshtroheni urdhrit të mbikëqyrjes së detyrueshme, keni gjithashtu të drejtën të takoheni me prindërit ose kujdestarin tuaj në komisariatit e policisë.**
- 8. Ju keni të drejtën e ndihmës mjekësore urgjente.**



# Të drejtat tuaja

Vini re: Në rrethana të jashtëzakonshme, policia ka të drejtën të shtyjë ose të ndalojë ushtrimin e disa prej këtyre të drejtave nga ana juaj. Për shembull, nëse policia mendon se ju duhet të flisni patjetër, me qëllim evitimin e lëndimit të personave të tjetër. **Këtu nuk përfshihet e drejta juaj për të mos folur.**

## 1. Informacion për personat që mbahen në paraburgim

- **E drejta për të qëndruar të heshtur**

Nuk jeni të detyruar t'i përgjigjeni asnjë pyetje që ju bën policia rreth shkeljes që mendojnë se keni kryer.

Çdo gjë që thoni do të mbahet shënim ose regjistrohet dhe mund të përdoret në gjykatë si provë, nëse çështja juaj kalon në gjykatë.

Jeni të detyruar t'i thoni policisë, emrin dhe adresën tuaj, datën e lindjes, vendin e lindjes dhe kombësinë kur ata t'ju pyesin për këto të dhëna.

- **Njoftimi i një avokati që jeni në komisariatit e policisë**

Mund t'i kërkonti policisë të njoftojë një avokat që jeni në komisariatit e policisë. Ai mund të jetë avokati juaj ose, nëse nuk njihni një avokat, mund të kontaktohet një avokat në detyrë. Policia do të bëjë të mundur që të kontaktohet një avokat sa më parë të jetë e mundur. Ky shërbim është falas.

- **Njoftimi i dikujt tjetër që jeni në komisariatit e policisë**

Mund t'i kërkonti policisë të kontaktojë dikë tjetër për t'i komunikuar se ndodheni në komisariatit e policisë. Ky person mund të jetë një pjesëtar i familjes tuaj, partner, kujdestar, mik i juaji ose një person tjetër që njihni. Policia do të kontaktojë dikë për ju, sa më parë të jetë e mundur.

### **Nëse jeni nën 16 vjeç (ose nën 18 vjeç dhe i nënshtroheni urdhrorit të mbikëqyrjes së detyrueshme):**

- Policia duhet të përpiqet të informojë prindin ose kujdestarin tuaj që jeni në komisariatit e policisë.
- Prindi ose kujdestari juaj mund të vijë dhe t'ju japë përkrahje në komisariatit e policisë.

- **Marrja e një përkthyesi për t'ju ndihmuar**

Nëse nuk flisni ose kuptoni anglisht, policia do të bëjë të mundur që të merrni ndihmë nga dikush i cili flet gjuhën tuaj (një përkthyes). Ky shërbim është falas. Është e rëndësishme që të mund të kuptoni se çfarë po thuhet në komisariatit e policisë.

Nëse keni probleme me dëgjimin ose vështirësi për të komunikuar qartë, policia do të thërrasë dikë që t'ju ndihmojë gjatë marrjes në pyetje. Ai mund të jetë një interpretues i gjuhës angleze të shenjave, ose një profesionist tjetër përkatës. Ky shërbim është falas.

- **Nëse nuk jeni shtetas britanik**

Nëse nuk jeni shtetas britanik, mund t'i kërkonti policisë të kontaktojë me Komisionin e Lartë, Ambasadën ose Konsullatën tuaj që t'i njoftojë ata se ku jeni dhe se pse jeni në komisariatit e policisë. Gjithashtu, ata mund t'ju vizitojnë privatisht dhe të bëjnë të mundur që të takoni një avokat.

- **Çfarë ndodh nëse akuzoheni ose çoheni në paraburgim bazuar në një urdhër arresti?**

Nëse akuzoheni për një shkelje, mund të liroheni nga arresti ose të mbaheni në komisariatit e policisë dhe të çoheni në gjykatë mëngjesin e ditës tjetër. Ose mund të liroheni nëse bini dakord që të paraqiteni në gjykatë në një datë të caktuar.

- **E drejta për të parë dokumentet**

Provat e çështjes do t'ju jepen ju ose avokatit tuaj nëse çështja shkon në gjykatë. Kjo do t'ju lejojë ju ose avokatit tuaj të përgatisë mbrojtjen.

Keni të drejtën e përkthimit të informacionit përkatës nëse nuk kuptoni anglisht.

- **Nëse jeni i sëmurë ose i lënduar**

Policia do t'ju bëjë pyetje rreth shëndetit dhe mirëqenies tuaj. Policia mund t'i kërkojë një mjeku që t'ju ekzaminojë. Kjo bëhet për t'u siguruar se ndaj jush po tregohet kujdes i duhur ndërkohë që jeni në paraburgim. Nëse ndiheni se keni nevojë të takoni një mjek atëherë komunikojani policisë. Nëse sëmurëni, do t'ju jepet ndihmë mjekësore.

- **Ushqimi dhe pijet**

Do t'ju jepet ujë sa herë që kërkonti. Do t'ju jepet ushqim nëse keni qenë në paraburgim për një periudhë më të gjatë se katër orë. Nëse keni ndonjë kërkesë mbi dietën ose të lidhur me fenë, atëherë thuajani policisë sa më parë të jetë e mundur.

## **Nëse ju nevojitet ndihmë shtesë (vini re, ky është informacion rreth një shërbimi dhe nuk është një e drejtë e juaja):**

Mund t'ju nevojitet ndihmë për të kuptuar se çfarë po ndodh kur jeni në komisariatit e policisë. Kjo ndihmë mund të ofrohet nga një person mbështetës i quajtur i Rrituri i Përshtatshëm. Ky rast mund të gjejë zbatim për ju nëse keni një çrregullim mendor ose paaftësi për të mësuar. **Flisni me policinë nëse mendoni se ju nevojitet kjo mbështetje.**

Nëse policia mendon se ju nevojitet mbështetja e një të Rrituri të Përshtatshëm, ata do të kërkojnë praninë e një personi të tillë që të vijë, edhe nëse ju nuk e kërkon.

## **2. Informacion për personat që do të merren në pyetje nga policia**

### **• Marrja e një avokati për t'ju ndihmuar**

- Flisni me policinë nëse kërkon një avokat. Policia do të kontaktojë një avokat sa më parë të jetë e mundur.
- Avokati do t'ju thotë nëse mund t'ju këshillojë falas ose nëse do t'ju duhet të paguani për këshillimin. Nëse duhet të paguani, ata do t'ju shpjegojnë se sa kushton dhe mënyrën si mund të paguani. Policia nuk paguan për avokatin tuaj dhe nuk diskuton rreth mënyrës sesi paguhet ai.
- Normalisht, policisë nuk i lejohet t'ju marrë në pyetje pa praninë e avokatit nëse keni kërkuar që ai të jetë i pranishëm në dhomë me ju.
- Ndonjëherë, policia duhet t'ju bëjë pyetje urgjente përpara se të flisni me një avokat.
- Nëse bisedoni me një avokat, kjo nuk ju bën të dukeni sikur keni bërë diçka të gabuar.
- Në çfarëdolloj kohe mund të ndryshoni mendje nëse doni të flisni me një avokat. Thuajini policisë sa më parë të jetë e mundur dhe ata do të kontaktojnë një avokat për ju.
- Roli i avokatit është të mbrojtë të drejtat tuaja dhe t'ju këshillojë rreth ligjit.
- Mund të zgjidhni të flisni me një avokat që njihni ose me avokatin në detyrë. Avokati në detyrë është i pavarur dhe nuk punon për policinë.
- Nëse një oficer i lartë policie jep leje, një inspektor në uniformë mund të jetë i pranishëm gjatë konsultimit me avokatin tuaj.
- Keni të drejtën të keni një bisedë private me një avokat.
- Mund të kërkon që avokati të jetë në dhomë me ju kur policia ju merr në pyetje.
- Nëse avokati nuk vjen në komisariatit e policisë në kohën e rënë dakord, ose nëse duhet të flisni sërish me avokatin, kërkojini policisë ta kontaktojë përsëri.

- **Për sa kohë mund të mbaheni i ndaluar për t'u marrë në pyetje?**

Policia mund t'ju mbajë të ndaluar për t'ju marrë në pyetje deri në 48 orë, pa ju akuzuar për një shkelje. Herë pas here, një oficer i lartë policie duhet të shikojë çështjen tuaj për të parë nëse duhet ende të mbaheni të ndaluar. Ky quhet shqyrtim. Mund të mbaheni të ndaluar më gjatë se 48 orë vetëm nëse gjykata e lejon këtë. Gjykata mund ta zgjasë periudhën e ndalimi pa akuza, maksimumi deri në 14 ditë nga arrestimi. Në rast të tillë, do t'ju paraqiten dokumentet në vijim:

- Një dokument me shkrim që tregon se është bërë kërkesa për të zgjatur ndalimin tuaj;
- Koha kur është bërë aplikimi;
- Koha kur kërkesa do të shqyrtohet në gjykatë dhe
- Arsyeja/et se pse kërkohet zgjatja e ndalimit.

Ju (dhe përfaqësuesi juaj ligjor) do të njoftoheni çdo herë që bëhet një kërkesë për të zgjatur më tej ndalimin tuaj.

Ju dhe avokati juaj keni të drejtën të shprehni mendimin tuaj rreth këtij vendimi, me përjashtim të rasteve kur nuk jeni në gjendje të mirë shëndetësore. Avokati mund t'ju këshillojë rreth kësaj çështjeje.

## **Vizitorët e pavarur të personave në arrest**

Ka pjesëtarë të komunitetit të cilëve ju lejohet të vizitojnë komisariatit e policisë. Ata njihen si vizitorë të personave në arrest dhe punojnë mbi baza vullnetare për të garantuar se personat e ndaluar trajtohen siç duhet dhe janë informuar mbi të drejtat e tyre.

Ju nuk e keni të drejtën t'i takoni apo t'i kërkoni për takim këta vizitorë të pavarur të personave të arrestuar, janë vetë ata që kërkojnë t'ju takojnë. Nëse një vizitor i pavarur i personave të arrestuar ju viziton ndërkohë që ju jeni në paraburgim, ata do të veprojnë në mënyrë të pavarur nga policia për të kontrolluar që mirëqenia dhe të drejtat tuaja janë mbrojtur. Është zgjedhje e juaja për të folur ose jo me ta.